



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI BUJQËSISË DHE MJEDISIT
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE AGRONOMIKE

Tiranë më, 24 / 05 / 2021

PROGRAMI I PRAKTIKES PROFESIONALE

(Pranë Bashkisë)

Programi i praktikës profesionale për studentët e vitit të tretë *“Prodhim Bimor”* të Departamentit të Shkencave Agronomike të cilët janë të interesuar në fushën organizative.

Bashkia do të orientojë studentët gjatë periudhës katër javore (24.05.2021 – 18.06.2021).

Gjatë kryerjes së praktikës profesionale në këtë institucion studentët duhet të njihen dhe të aftësohen praktikisht lidhur me:

- Këshillimin e fermerëve dhe sensibilizimin e tyre mbi kultivimin e tokave bujqësore.
- Përshtatjen e kulturave me nevojat e tregut.
- Përdorimin sa më efikas të aseteve që ata disponojnë.
- Shërbimin Këshillimor Bujqësor (ekstensionin) për realizimin e politikave të zhvillimit rural që ka për detyrë të kontribuojë në rritjen e prodhimit bujqësor dhe të ardhurave të fermerëve.
- Procedurat për dhënien me qera të tokave bujqësore

Në përfundim të Praktikës studenti duhet të shoqërohet nga një vlerësim individual me shkrim i cili duhet të firmoset dhe të vuloset nga ana Juaj.

Gjithashtu, studenti në përputhje me programin, do paraqesë një raport të detajuar për të gjithë veprimtarinë e kryer në këtë institucion. Raporti do të vlerësohet me notë dhe njëkohësisht do jetë vlerësim për gjithë praktikën profesionale.

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc. Dr. Lirika KUPE